



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

PËRDITËSIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR VITIN 2026



Janar, 2026

Përditësimi i Planit të Integritetit për Vitin 2026

Në bazë të Vendimit nr. 733, të datës 04.09.2024, të nxjerrë nga Ushtruesja e Detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, është caktuar Grupi Punues përgjegjës për rishikimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR). Ky grup ka mandatin të sigurojë që procesi i përditësimit të planit të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore, dokumentet udhëzuese dhe standardet e përcaktuara nga institucionet përgjegjëse.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, konkretisht nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), si dhe në pajtim me Metodologjinë për Hartimin e Planit të Integritetit, të miratuar me vendim të datës 26.07.2023 nga APK, institucionet publike janë të obliguara të hartojnë, miratojnë dhe t'i nënshtrojnë rishikimit vjetor planet e tyre të integritetit. Plani i Integritetit është dokument trevjeçar i cili duhet të përditësohet çdo vit nga institucioni përkatës, duke reflektuar ndryshimet strukturore, normative dhe operacionale.

Në përmbushje të këtyre kërkesave ligjore dhe institucionale, MZHR ka ndërmarrë hapat për rishikimin e Planit të Integritetit për periudhën 2024–2026. Ky rishikim është pjesë e një procesi të rregullt dhe sistematik, i cili synon të sigurojë që plani të jetë në përputhje me zhvillimet më të fundit normative, organizative dhe politike, si dhe të adresojë në mënyrë efektive çdo element të cenueshmërisë së mundshme institucionale.

Procesi i rishikimit vjetor është mbështetur në një vlerësim të strukturuar dhe gjithëpërfshirës të cenueshmërisë së integritetit brenda MZHR-së, duke përfshirë identifikimin e faktorëve të riskut, analizën e kontroleve të brendshme dhe përcaktimin e masave të nevojshme për përmirësim. Ky proces shpreh përkushtimin e vazhdueshëm të institucionit për forcimin e mekanizmave të brendshëm të integritetit, rritjen e transparencës, parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe avancimin e nivelit të llogaridhënies dhe performancës institucionale.

Për realizimin e përditësimit të Planit të Integritetit për vitin 2026, janë zhvilluar një sërë aktivitete, përfshirë takimet grupore të mbajtura më 28.10.2025, si dhe takimet individuale me të gjitha njësitë për të njëjtin qëllim. Po ashtu, nga data 6 -8 nëntor 2025 u organizua një punëtori, ku krahas anëtarëve të Grupit Punues morën pjesë edhe drejtues departamentesh, udhëheqës njësish dhe zyrtarë tjerë relevantë të MZHR-së. Procesit është mbështetur edhe përmes komunikimit elektronik, gjatë të cilit menaxhmenti është angazhuar në plotësimin e shablloneve dhe kërkesave të përcaktuara nga APK. Ky bashkëpunim brenda institucionit me njësitë të cilat janë parapara me masa të rrezikut ka mundësuar mbledhjen e informacionit të domosdoshëm dhe reflektimin e tij në mënyrë koherente në përditësimin e draftit të planit.

Si rezultat i këtij procesi, nga departamentet dhe njësitë e institucionit janë hequr gjashtë masa, ndërsa të tjerat janë ruajtur ose janë riformuluar sipas nevojës.

Përditësimi i Planit të Integritetit për vitin 2026 i hartuar nga Grupi Punues, është miratuar nga U.D. Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, bazuar në Vendimin nr. 18, të datës 13.01.2026.

Fushat e përgjithshme të rrezikut

Përmbledhje e veprimeve dhe rekomandimeve për Përditësimin e Planit të Integritetit për vitin 2026.

1. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme:

Masa për sigurinë e të dhënave në TI është përmbushur pa vështirësi, pasi stafi informohet rregullisht dhe bashkëpunimi me ASHI-në. Kjo masë vazhdon edhe në vitin 2026 për shkak të rëndësisë së saj për mbrojtjen e të dhënave.

Inventarizimi i pasurisë përmes sistemit e-pasuria është kryer me sukses dhe nuk ka pasur sfida, prandaj masa konsiderohet e përmbushur dhe hiqet nga Plani i Integritetit.

Masa për dërgimin e materialeve arkivore në Arkivin Shtetëror mbetet e papërmbushur për shkak të kufizimeve ligjore dhe afatit të gjatë të procesit, për këtë arsye rekomandohet të largohen nga Plani i Integritetit.

Ndërkohë, masa për sigurimin e hapësirave dhe inventarit për ruajtjen e materialit arkivor është përmbushur pjesërisht, pasi ekzistojnë dy depo, por nevojiten hapësira shtesë. Kjo masë vazhdohet në vitin 2026, për shkak të nevojës së vazhdueshme për kushte adekuate të ruajtjes së dokumenteve arkivore.

2. Burimet Njerëzore (NJMBNJ):

Rreziku i kryerjes së detyrave shtesë nga zyrtarët, jashtë përshkrimit të vendit të punës, është identifikuar si faktor që cenon llogaridhënien dhe efektivitetin institucional. Për zbutjen e këtij rreziku, MZHR kishte planifikuar rritjen e numrit të stafit në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH). Megjithatë, kërkesa për rritje të stafit nuk është aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, duke e bërë masën të pazbatueshme nga ana e MZHR-së.

Për shkak se rekrutimi dhe zgjerimi i stafit nuk janë më në kompetencë të MZHR-së, institucioni nuk ka kontroll mbi këtë proces dhe rrjedhimisht nuk mund të menaxhojë rrezikun përmes kësaj mase. Si përfundim, masa është vlerësuar jo e përmbushur dhe është hequr nga Plani i Integritetit, pasi në rrethanat aktuale mbetet e pa aplikueshme dhe jashtë fushës së përgjegjësisë institucionale.

Pra, planifikimi, koordinimi dhe administrimi i trajnimeve dhe vizitave studimore, si dhe monitorimi i deklaratimit të pasurisë dhe dhuratave, dhe do të ruhen për vitin 2026. Një nga masat që nuk është e zbatueshme institucionalisht do të hiqet sipas rekomandimit të NJMBNJ, duke garantuar që Plani i Integritetit të mbetet praktik dhe i zbatueshëm.

3. Divizioni për Buxhet dhe Financa

Rreziku për ndryshime të mundshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit të buxhetit menaxhohet përmes planifikimit adekuat të buxhetit në proporcion me shpenzimet. DBF dhe njësitë e MZHR-së e zbatojnë këtë masë në vazhdimësi, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. Sa i përket kësaj njësie, nuk është paraqitur nevoja për ndryshim apo riformulim të masës.

Fushat e veçanta të rrezikut

1. Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal

Të gjitha masat e identifikuar ruajnë rëndësinë e tyre për vitin 2026, duke kërkuar përmirësime kryesisht në koordinim, planifikim dhe sigurimin e informacionit të saktë për implementim të suksesshëm.

Të tri masat janë zbatuar pjesërisht, duke treguar progres, por edhe duke theksuar sfida strukturore dhe operative. Pengesat kryesore lidhen me mungesën e stafit, burokracinë ndërinstucionale dhe pasigurinë e tregut.

Të tre masat rekomandohet të ruhen, por të shoqërohen me përmirësim të mekanizmave të brendshëm dhe ndërinstucionalë të koordinimit, si dhe me përdorimin e burimeve më të besueshme për vendimmarrje.

2. Njësia e Auditimit të Brendshëm

Dy masat e para, të cilat lidhen me raportimin, monitorimin dhe përgatitjen e planeve të veprimit për rekomandimet e auditimit, nuk janë përmbushur për shkak të mungesës së plotësisht të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Masa e tretë, që synon rritjen e stafit të NJAB, është e pazbatueshme pasi kapërcen kompetencat e MZHR-së, për këtë arsye, ajo hiqet nga Plani i Integritetit .

Gjate periudhës raportuese, tri masa të lidhura me Auditimin e Brendshëm kanë rezultuar **jo të përmbushura**. Dy prej tyre raportimi periodik dhe përgatitja e planeve të veprimit nuk janë zbatuar për shkak të mosveprimit nga departamentet dhe mungesës së monitorimit efektiv nga NJAB, e cila nuk ka funksionuar për shkak se pozita ka qene e pa plotësuar. Megjithatë, këto masa mbeten të rëndësishme dhe **duhet të ruhen** në Planin e vitit 2026.

3. Divizioni i Prokurimit

Gjatë periudhës raportuese, të gjitha masat e Planit të Integritetit të lidhura me procesin e prokurimit janë zbatuar plotësisht dhe pa vështirësi të theksuara.

Masa që lidhet me rritjen e profesionalizmit në pranimin e mallrave dhe menaxhimin e kontratave është realizuar me sukses përmes zbatimit të rregullores së re të prokurimit dhe trajnimit të stafit, ndaj konsiderohet e përmbushur dhe hiqet nga Plani i Integritetit.

Po ashtu, edhe masa për ngritjen e kapaciteteve për hartimin e specifikimeve teknike është përmbushur plotësisht falë plotësimin të stafit dhe funksionimit të qartë të njësive kërkuese; aktivitetet e prokurimit janë realizuar pa probleme, prandaj kjo masë gjithashtu hiqet.

E vetmja masë që mbetet është ajo që lidhet me përmirësimin e procesit të hartimit të planit vjetor të prokurimit. Edhe pse për vitin 2025 procesi është zhvilluar me sukses dhe pa vështirësi, natyra periodike dhe sfidat e përvitshme të planifikimit e bëjnë të nevojshme ruajtjen e kësaj mase edhe për vitin 2026.

Në përgjithësi, niveli i integritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet njësive është vlerësuar pozitiv, ndërsa rreziqet kryesore të identifikuara më parë janë reduktuar në masë të madhe.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT

Identifikimi i rrezikut		Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut			
Nr.	Fusha rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	Mos koordinimi dhe informimi i Njesisë së Burimeve Njerëzore për trajnimet dhe punëtoritë ku marrin pjesë zyrtarët, çka paraqet mangësi në procesin e zhvillimit të stafit. Vizitat studimore të stafit jashtë vendit, të organizuara nga MZHR ose donatorët, nuk koordinohen mjaftueshëm me njësitë përkatëse për pjesëmarrje e stafit në to.	Legjislacioni në fuqi që rregullon menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin profesional dhe integritetin.	4	3	12	Planifikimi në fillim të vitit i trajnimeve, vizitave studimore jashtë vendit dhe aktiviteteve të tjera të zhvillimit profesional, si dhe regjistrimi i tyre në sistemin përkatës për menaxhimin e burimeve njerëzore.	Departamentet dhe Divizionet e MZHR-së	TM1
		Mungesa e njohurive të zyrtarëve lidhur me integritetin dhe kundër korrupsionin.	Raportet periodike mbi trajnimet e zyrtarëve.	3	6	18	Realizimi i trajnimeve specifike për integritetin dhe luftën kundër korrupsionit.	ZKA - NJMBNJ	TM2
		Mos deklarimi i mundshëm i dhuratave nga ana e zyrtarëve.	Kuadri ligjor që përcakton obligimin për deklarimin e dhuratave.	8	3	24	Informimi i zyrtarëve për obligimet ligjore dhe pasojat e mundshme të mos deklarimit të dhuratave.	NJMBNJ	TM1 të çdo viti fiskal.

2	Shërbime të përgjithshme	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Ligjet dhe aktet nënligjore	4	9	36	Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative. Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rreziqet nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të sistemeve	DSHP /DTIL	TM4
		Ruajtja dhe administrimi i lëndëve arkivore të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal	Ligjet dhe aktet nënligjore	5	6	30	Krijimi i kushteve dhe hapësira	DSHP /DADA	Në vazhdimësi.
3	Menaxhimi i financave	Ndryshimet e mundshme nga planifikimi në realizim të buxhetit	Legjislacioni në fuqi	4	6	24	Planifikimi i buxhetit adekuat në proporcion me shpenzimet	DBF dhe njësitë brenda MZHR-së	Në vazhdimësi të çdo viti fiskal

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1	Planifikim Koordinim për Zhvillim Rajonal	Mungesa e stafit të mjaftueshëm për krijimin e komisioneve për monitorimin e granteve, gjë që ndikon në cilësinë dhe efikasitetin e procesit të monitorimit.	Kuadri ligjor në fuqi që rregullon procesin e planifikimit, monitorimit dhe implementimit të projekteve zhvillimore.	6	6	36	Caktimi i stafit profesional dhe adekuat për monitorimin e projekteve.	ZKA / DPKZHR	TM4
		Vonesa në realizimin e projekteve kapitale të bashkë financuara nga MZHR, e cila mund të ndikojë negativisht në zbatimin me kohë të aktiviteteve dhe në sigurimin e financimit të plotë.	Procedurat dhe udhëzuesit për zbatimin dhe monitorimin e projekteve dhe menaxhimin e granteve.	5	6	30	Komunikimi i vazhdueshëm me akterët relevant dhe koordinimi i rregullt ndërinstitucional.	DPKZHR	TM4
		Ndryshimi i çmimeve të pajisjeve në ofertën e përfituesit gjatë fazës së implementimit, që mund të rezultojë në paraqitjen e çmimeve më të larta se vlera reale e tregut, duke shkaktuar devijime financiare, rritje të kostove dhe rrezik për keqpërdorim të fondeve të grantit.	Udhëzuesit dhe rregulloret që përcaktojnë mënyrën e shpenzimit të fondeve publike dhe kontrollin e tyre.	7	8	56	Verifikimi i çmimeve me tregun përmes krahasimeve të rregullta dhe dokumentimit të burimeve të çmimeve.	DPKZHR	TM4

2	Prokurimi Publik	Mangësi në procesin e hartimit të planit të prokurimit dhe zbatimit të tij	Ligjet dhe aktet nënligjore	7	8	56	Vlerësimi me kujdes i nevojave të departamenteve dhe njësive të veçanta të MZHR-së dhe përfshirja e tyre në Plan të Prokurimit si dhe pjesëmarrja e njësive kërkuese në takimet rreth planifikimit të prokurimit	ZKA, DP dhe Njësitë kërkuese	TM1
3	Auditimit i Brendshëm	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga raportet Njësia e auditorit të Brendshëm(NJAB)	Ligjet dhe aktet nënligjore	2	8	16	Raportimi periodik nga ana e drejtorëve të departamenteve dhe udhëheqësit e njësive të veçanta të audituara për zbatimin e rekomandimeve të NJAB. Verifikimin në baza tre mujore rreth zbatimit të rekomandimeve të NJAB, dhe njoftimi i USPP dhe Komitetit të Auditimit.	NJAB dhe Njësit e audituara brenda MZHR-së	TM2-TM4
		Mos përgatitja e të gjitha planeve të veprimit për implementimin e rekomandimeve nga Departamentet dhe Njësit e veçanta të audituara nga NJAB	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	9	27	Me përfundimin e raportit final Përgatitja e Planeve për Implementimin e rekomandimeve	NJAB dhe Njësit e audituara brenda MZHR-së	TM1 deri TM4